



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun



Rruga Durrësit, nr. 83, Tiranë. Tel/Fax: 04 227850. E-mail: iss@iss.gov.al. Web: www.iss.gov.al

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2017

FTESË PËR NEGOCIATA

Drejtuar: Organeve të Masmedias/Agjencive të Specializuara

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ka parashikuar botimin e një suplementi informues me kohëzgjatje 1 (një) ditë, ku do të sqarohet mënyra sesi po realizohet përfshirja në skemën e sigurimeve shoqërore, nëpërmjet sigurimit vullnetar dhe sigurimit të detyrueshëm si të vetëpunësuar në bujqësi, si dhe procedurat dhe përfitimet nga Ligji nr. 8/2017, datë 02.02.2017 “Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe gazit”.

Mbështetur në VKM nr. 1195, datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin dhe bashkëprodhimin e programeve të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar dhe për kontratat për kohë transmetimi nga organet e administratës shtetërore”, Instituti i Sigurimeve Shoqërore zhvillon procedurën (për negociata) për botimin e këtij suplementi në gazetën me tirazhin më të madh në vend me objekt: “Përfitimet nga përfshirja në skemën e sigurimeve shoqërore dhe si përfitohet nga Statusi i Punonjësve të Naftës dhe Gazit”.

OBJEKTI I SUPLEMENTIT

Objekti i botimit të suplementit do të jetë: “Përfitimet nga përfshirja në skemën e sigurimeve shoqërore dhe si përfitohet nga Statusi i Punonjësve të Naftës dhe Gazit”.

Nevoja për kryerjen e programit: Përfitimet nga përfshirja në skemën e sigurimeve shoqërore dhe procedura e realizimit të saj. Përfitimet nga Statusi i Punonjësve të Naftës dhe Gazit si dhe për dhënien e dëshmisë së statusit të punonjësve të industrisë së naftës dhe gazit, kriteret dhe procedurat për lëshimin e vërtetimit të posaçëm zyrtar.

Shpeshtësia e shfaqjes së reklamës: 1 (një) herë.

Numri i faqeve: 6 (gjashtë) faqe të plota, në mes të gazetës, me mundësi shkëputjeje nga lexuesi.

Periudha e realizimit të reklamës: gjatë ditëve të javës.

Fondi limit i përcaktuar: 640, 000 (gjashtëqind e dyzetë mijë) lekë, pa TVSH.

Afati i fundit për paraqitjen e konfirmimeve nga media e shkruar është deri më datë 09. 08. 2017, ora 11.00, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Konfirmimet për vazhdimësinë e negociatave: Konfirmimet duhet të vijnë të gjitha në një ditë të vetme, të mbyllura në zarf jo transparent, të firmosur dhe vulosur në emrin dhe adresën e subjektit dhe me shënimin: **“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMTI TË OFERTAVE, DHE JO PARA DATËS 09.08.2017, ORA 11.00”**.

Në rast të kundërt ato do të refuzohen dhe do të kthehen të pahapura.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë autoritetit tonë kontraktor:

Emri: INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
Adresa: Rr. Durrësit, nr. 83, Tirane
Tel/Fax: 042 227 850
Adresa e Internetit: www.iss.gov.al
Në emër të: Komisionit për Ndjekjen e Procedurave për botimin e suplementit në median e shkruar
E-mail mzenelaj@iss.gov.al

Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave janë:

Shqip ☒ Anglisht
Tjetër _____

Termat e Referencës:

Qëllimi i këtij suplementi është sqarimi i të gjithë qytetarëve të interesuar për t'u përfshirë në skemën e sigurimeve shoqërore nëpërmjet pagesës së sigurimit vullnetar dhe sigurimit të detyrueshëm si të vetëpunësuar në bujqësi. Gjithashtu pjesë e këtij suplementi do të jenë edhe përfitimet nga Statusi i Punonjësve të Naftës dhe Gazit, si dhe procedura që do të ndiqet për dhënien e dëshmisë për marrjen e këtij statusi.

Duke iu referuar interesimit të madh të qytetarëve lidhur me të dy këto procese, ISSH do të kërkojë përmes gazetës me tirazhin më të madh dhe me mundësinë e përhapjes përmes faqes online, sqarimin e plotë të tyre.

Në suplement duhet të përfshihen procedurat e e pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore si dhe përfitimet që kanë qytetarët nga këto pagesa. Gjithshtu duhet të sqarohen plotësisht përfitimet që rrjedhin nga marrja e Statusit të Punonjësve të Naftës dhe Gazit, si dhe procedura që do të ndiqet për dhënien e dëshmisë për marrjen e këtij statusi.

Botimi duhet të jetë në gazetën me përhapjen sa më të gjerë dhe me publikim edhe në faqen online.

Në prodhimin e suplementit ISSH ofron materialin, ndërkohë që dizenjimi, ilustrimi me fotot përkatëse dhe redaktimi i materialit, që do të botohet, janë detyrim i stafit të gazetës.

Gazeta do të konsultojë titujt me Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median në ISSH.

INFORMACIONE APO KËRKESA SHITESË:

Dokumentacioni ligjor që duhet paraqitur si kriter kualifikues:

1. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):

- a.** nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv);
- b.** nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP;
- c.** nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional.

Kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit “Deklaratë mbi Gjendjen gjyqësore”.

Në rastin kur kandidati/ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, në vend të Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, do të paraqitet vendimi i Gjykatës për regjistrimin si person juridik, sipas Ligjit nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jofitimprurëse”.

2. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):

- a.** ka plotësuar detyrimet fiskale;
- b.** ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuara nga administrata tatimore.

Kriteret e përgjithshme për pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Këto kritere (pikat 1,2) duhet të vërtetohen përmes dokumentave të lëshuara, jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.

- 3.** Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik, që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë.
- 4.** Ofertën, ku të jetë specifikuar oferta për botim në median e shkruar.
- 5.** Shërbime të së njëjtës natyrë, të realizuara gjatë tre viteve të fundit, për këtë të paraqitet kontratë dhe vërtetim realizimi dhe /ose faturë tatimore.
- 6.** Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit

Përzgjedhja e ofertave do të bëhet sipas pikës nr. 7 dhe 12, të VKM nr. 1195, datë 05.08.2008.

Kriteret e vlerësimit:

- Tirazhi më i lartë dhe me shpërndarje në të gjithë vendin;
- Dokumentacioni ligjor i paraqitur nga organet e masmedias.
- Çmimi me i ulët, i ofruar nga organi i masmedias.

Vlerësohet me 35 pikë tirazhi më i lartë, ku përfshihet edhe faqja online.

Vlerësohet me 15 pikë dokumentacioni ligjor i paraqitur.

Vlerësohet me 50 pikë çmimi i ofruar nga organi i masmedias/agjencia e specializuar.

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në lekë, pa TVSH.

Ofertuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hapjes së ofertave, përfaqësuesit apo personat me autorizim.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Zyra e Protokollit, kati i parë, para orës së përcaktuar.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë e cila do të dorëzohet tej afatit të përcaktuar dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme. Dokumentacioni duhet të paraqitet origjinal ose kopje e noterizuar e tyre.

Këtë ftesë për negociata mund ta gjeni dhe në faqen e internetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ne adresën: www.issh.gov.al

Jemi në pritje të konfirmimit tuaj për negociim.